



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 17 gusht 2011  
Nr. ref.: RK 133/11

## VENDIM PËR HEQJEN NGA LISTA TË KËRKESËS

në

**Rastin Nr. KO 107/10**

Parashtruesi

**Gani Geci dhe deputetët tjerë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Kuvendit, të datës 14 tetor 2010,  
në lidhje me Strategjinë dhe Projekt-Vendimin e Qeverisë për privatizimin e  
Postë-Telekomit të Kosovës**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë 12 deputetë (emrat e të cilëve janë cekur në aneksin e Projekt-Aktvendimit), të përfaqësuar nga njëri prej tyre, z. Gani Geci.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i kontestuar prej parashtruesve është Vendimi i Kuvendit, i 14 tetorit 2010, për Strategjinë dhe Projekt-Vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Projekt-Strategjia për PTK).

## **Objekti i çështjes**

3. Çështje e lëndës së kërkesës është që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vlerësojë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit, të datës 14 tetor 2010, me të cilin u miratua Strategjia dhe Projekt-Vendimi i Qeverisë për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës.
4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit të datës 14 tetor 2010, duke pretenduar shkeljen e nenit 51 paragrafët (1), (2) dhe (3) të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës e Kuvendit).
5. Parashtruesit e kërkesës pohojnë, në veçanti, se për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm gjatë votimit është shkelur neni 51 paragrafët (1), (2), dhe (3) të Rregullores së Kuvendit.

## **Baza juridike**

6. Neni 113.5 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 42 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009 (Nr. 03/L-121) (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

7. Më 22 tetor 2010, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën e tyre në Gjykatë.
8. Më 16 dhjetor 2010, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 107/10, emëroi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 107/10, emëroi Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
9. Më 19 janar 2011, për kërkesën është njoftuar Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).
10. Më 3 maj 2011, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga Kuvendi, i cili i dorëzoi ato me 5 maj 2011.
11. Më 6 korrik 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 12 tetor 2010, Kryetari i Kuvendit thirri një seancë plenare të Kuvendit për 14 tetor 2010. Në agjendën e seancës, mes tjerash, u paraqit të shtjellohej miratimi i Strategjisë dhe Projekt-Vendimit të Qeverisë për privatizimin e PTK-së.
13. Më 14 tetor 2010, Kuvendi mbajti seancë plenare dhe votoi për Projekt-Strategjinë e PTK-së. Pas votimit, Kryetari i Kuvendit deklaroi se pesëdhjetë (50) deputetë ishin të

pranishëm dhe se, nga ata pesëdhjetë (50), dyzet e shtatë (47) deputetë votuan për, dy (2) kundër dhe një (1) abstenoï.

14. Pas votimit, Kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi, përfundoi se Strategjia dhe Projekt-Vendimi i Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së ishin miratuar.

#### **Argumentet e parashtruesve të kërkesës**

15. Parashtruesit e kërkesës thonë se folësi/Kryetari i Kuvendit z. Jakup Krasniqi, kishte vënë në votim vendimin për privatizimin e PTK-së pa pasur kuorumin e nevojshëm të deputetëve të paraparë me nenin 51(1), (2) dhe (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, gjegjësisht më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

#### **Përgjigja nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës**

16. Më 5 maj 2011, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Jakup Krasniqi, dorëzoi komentet e veta për kërkesën e parashtruesve të kërkesës.
17. Ai u përgjigj se nuk kishte vendim të nënshkruar për miratimin e Strategjisë dhe Projekt-Vendimit të Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së.
18. Ai për më tepër shtoi se, më 28 tetor 2010, kishte marrë vendimin (Vendimin Nr. 03-V-448) për të mos miratuar Projekt-Strategjinë dhe Vendimin, pasi që deputetët ishin ankuar për mungesë të kuorunit, dhe se këto tekste do të dorëzoheshin për rishqyrtim në një fazë më të vonë.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

19. Parashtruesi i kërkesës pohon se është shkelur neni 51 [Kuorumi dhe votimi në seancat e Kuvendit] i Rregullores së punës së Kuvendit, kur më 14 tetor 2010, Kuvendi miratoi Projekt-Strategjinë për PTK-në në një seancë plenare.
20. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesve, është e nevojshme që së pari të vlerësojë nëse ata i kanë plotësuar kërkesat e parapara me Kushtetutë siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës.
21. Sa i përket kësaj kërkesë, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse mund të konsiderohet se parashtruesit e kërkesës i kanë plotësuar kushtet e parapara me nenin 113.5 të Kushtetutës, ku thuhet se: "Dhjetë (10) apo më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, në afatin prej tetë (8) ditësh nga data e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e cilitdo ligj apo vendim të miratuar nga Kuvendi, sa i përket përmbajtjes dhe procedurave të ndjekura".
22. Gjykata vëren se kjo kërkesë ishte dorëzuar nga dymbëdhjetë (12) deputetë që kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Kuvendit për Strategjinë dhe Projekt-Vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së.
23. Për më tepër, sa i përket kriterit të nenit 113.5 të Kushtetutës se parashtruesit e kërkesës duhet të kishin paraqitur kërkesën "brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga data e miratimit" të cilitdo ligj apo vendim nga Kuvendi, Gjykata vëren se me letren e 11 majit 2011, Kryetari i Kuvendit ka informuar Gjykatën se me Vendimin Nr. 03-V-448, të 28 tetorit 2010, ai ka vendosur që për shkak të mungesës së kuorunit të nevojshëm në seancën plenare të Kuvendit më 14 tetor 2010, vendimi i Kuvendit për miratimin

Strategjisë dhe Projekt-Vendimit të Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së do të konsiderohet se nuk është marrë fare.

24. Në këto rrethana, Gjykata konkludon se Vendimi i Kuvendit i 14 tetorit 2010, të cilin parashtruesit e kërkesës donin të kontestonin në këtë Gjykatë, është shfuqizuar nga Kryetari i Kuvendit dhe shih për këtë, ai nuk ekziston më.
25. Lidhur me këtë, Gjykata thirret në rregullin 32(4) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, i cili në masën përkatëse parasheh:

*“Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest”.*

26. Gjykata përfundon se, pas njoftimit që i është dorëzuar Gjykatës më 5 maj 2011 nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z. Jakup Krasniqi, ku thuhet se nuk pati vendim të nënshkruar për aprovimin e Strategjisë dhe Projekt-Vendimit të Qeverisë së Kosovës për privatizimin e PTK-së- kërkesa është pa objekt shqyrtimi.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe rregullin 32(4) dhe rregullin 56(2) të Rregullores së punës më 06 korrik 2011,

### **VENDOS**

- I. TA HEQË NGA LISTA kërkesën në përputhje me rregullin 32(4) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
- II. Që ky Vendim t’u dërgohet palëve dhe të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtarja raportuese**

Dr. Gjyljeta Mushkolaj

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. Dr. Enver Hasani

## **Aneksi A**

1. Gani Geci
2. Lulzim Zeneli
3. Naser Rugova
4. Driton Tali
5. Besa Gaxherri
6. Ismajl Kurteshi
7. Brahim Selmanaj
8. Sinavere Rysha
9. Mark Krasniqi
10. Drita Maliqi
11. Zafir Berisha
12. Naim Rrustemi